

# Ligj për arsimin e të rriturve

TEKST I KONSOLIDUAR ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018). Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë U.nr. 46/2008 prej 14 janar 2009, i shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 16/2009.

## I. DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

### Neni 1

Me këtë ligj rregullohet organizimi, struktura, financimi dhe menaxhimi i sistemit të arsimit për të rritur.

Arsimi për të rritur është pjesë e sistemit unik të arsimit në Republikën e Maqedonisë.

### Përkufizime

#### Neni 2

Disa nocione të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

- Arsimi për të rritur** është pjesë e sistemit arsimor i cili siguron arsimim, përsosje, aftësim dhe mësim për personat e rritur.
- Ofertues të shërbimeve të arsimit për të rritur** janë:
  - enti për arsimin e të rriturve** është shkolla, enti për arsim sipëror si dhe entet e specializuara për arsimin e të rriturve.
  - institucioni për arsimin e të rriturve** është personi juridik ose fizik i cili ka regjistruar veprimtari për arsimin e të rriturve.
- Punëdhënës** janë shoqëria tregtare, enti apo zëjtari te i cili bëhet aftësimi praktik i arsimit të të rriturve sipas kushteve vijuese të aktiviteteve të tyre, me ç'rast ky aftësim nuk paraqet veprimtari të tyre kryesore.
- Partnerë socialë** janë shoqata (sindikata shumicë dhe dhomat) të cilat i përfaqësojnë interesat e punëtorëve dhe punëdhënësve të cilët në bashkëpunim me organet e administratës shtetërore, me njësitë e vetadministrimit lokal e realizojnë sistemin e arsimit të të rriturve.
- Standard i profesionit** është përcaktimi i llojit të profesionit, niveli dhe kërkesat e punës dhe kompetencat, dija dhe shkathtësitë e nevojshme.
- Modul** është njësi autonome e të mësuarit, e cila si tërësi programore e mundëson fitimin e kompetencave, dijes dhe shkathtësive nga një fushë e caktuar.

7. **Programe publikisht të njohura për arsimin e të rriturve** janë programet për arsimin formal të cilat i miraton apo të cilave u jep pëlqim organi kompetent shtetëror.
8. **Programe të veçanta** janë programe për arsim joformal për marrjen e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave.
9. **Diplomë, dëftesë, vërtetim** janë dokumente publike me të cilat verifikohet mbarimi i një programi publikisht i njohur për arsimin e të rriturve.
10. **Certifikatë** është dokument me të cilin verifikohet mbarimi i një programi të veçantë për arsimin e të rriturve.
11. **Pjesëmarrës** është personi i cili inkuadrohet në programet arsimore për të rritur dhe i cili paraprakisht i ka plotësuar kushtet në aspekt të arsimit të detyrueshëm paraprak dhe persona të tjerë të cilët arsimohen, kurse nuk e kanë statusin e nxënësit.

## **Llojet e arsimit për të rritur**

### **Neni 3**

Arsimi për të rritur e përfshin mësimin formal, joformal dhe informal:

1. **Arsimi formal për të rritur** e përcakton veprimtarinë e cila realizohet në përputhje me ligjet të cilët e rregullojnë veprimtarinë e arsimit fillor, të mesëm dhe sipëror, nëse me këtë ligj ndryshe nuk është rregulluar.

Arsimi formal për të rritur është arsim i institucionalizuar i cili zbatohet në ente dhe institucione shtetërore e private si arsim i rregullt dhe me korrespondencë, sipas planeve dhe programeve përkatëse mësimore.

Arsimi formal për të rritur e përfshin:

- arsimin fillor për të rritur,
- arsimin e mesëm për të rritur, aftësimin profesional, arsimin profesional për profesion, arsimin teknik dhe arsimin pas mbarimit të shkollimit të mesëm për të rritur si dhe rikualifikimin dhe kualifikimin plotësues,
- arsimin sipëror për të rritur.

Arsimi formal për të rritur realizohet në përputhje me ligjet të cilat e rregullojnë këtë veprimtari, nëse me këtë ligj ndryshe nuk është rregulluar.

2. **Arsimi joformal për të rritur** i përcakton proceset e organizuara të mësimin të orientuara në drejtim të aftësimin të të rriturve për punë, për aktivitete të ndryshme sociale apo për zhvillim personal.

3. **Mësimi informal i të rriturve** paraqet aktivitete në të cilat të rriturit i pranojnë standardet dhe vlerat, shkathtësitë dhe njohuritë pozitive nga përvoja të përditshme dhe ndikimet tjera nga rrethina e vet.

## **Qëllimet dhe detyrat e arsimit për të rritur**

#### **Neni 4**

Qëllimi i arsimit për të rritur është që të sigurohet mundësia për fitimin e nivelit arsimor përkatës për gjithsecilin dhe për të gjitha grupmoshat e rritura, dhe të mundësojë të njëjtit të fitojnë dije, shkathtësi dhe qëndrime që do të jenë në përputhje me kërkesat e shoqërisë dhe tregut të punës.

Detyrat e arsimit për të rritur janë:

- mbarimi i së paku arsimit të detyrueshëm;
- aftësimi për punësimin e të rriturve të cilët nuk kanë mbaruar arsim të nivelit të parë të kualifikimeve profesionale;
- rikualifikimi dhe kualifikimi plotësues, aftësimi dhe trajnimi i personave të rritur të punësuar dhe të papunësuar;
- mundësimi i arsimit dhe fitimi i dijes dhe shkathtësive të cilat u përgjigjen aftësive personale dhe moshës së personave;
- fitimi i shkathtësive dhe kompetencave themelore përmes të cilave sigurohen bazat e mësimin të përjetshëm.

#### **Ofertues të shërbimeve të arsimit për të rritur**

#### **Neni 5**

Arsimin e të rriturve, në përputhje me këtë ligj, mund ta realizojnë entet publike dhe private të arsimit për të rritur, institucionet për arsimin për të rritur, qendrat për ngritje profesionale, punëdhënësit dhe partnerët socialë, shoqatat ose trajnuesit individualë të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

## **II. KOMPETENCAT E ARSIMIT PËR TË RRITUR**

#### **Kompetencat e arsimit për të rritur**

#### **Neni 6**

Kompetentë për arsimin e të rriturve janë ministria kompetente e arsimit (në tekstin e mëtejshëm: Ministria), ministria kompetente e punës, Këshilli për arsimin e të rriturve, njësitë e vetadministrimit lokal dhe partnerët socialë.

#### **Kompetencat e Ministrisë në fushën e arsimit për të rritur**

#### **Neni 7**

Ministria ka kompetencë:

- të miratojë strategji për arsimin e të rriturve dhe plane aksioni vjetor për realizimin e tij, në bazë të propozimeve nga Këshilli për arsimin e të rriturve;
- t'i propozojë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë rrjet të enteve për arsimin e të rriturve;
- t'i japë mendim Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndërprerjen e punës së enteve për arsimin e të rriturve, në mënyrë të përcaktuar me ligj;

- të bëjë verifikimin e enteve dhe të institucioneve për arsimin e të rriturve, në mënyrë të përcaktuar me ligj;
- të mbajë regjistër të enteve dhe institucioneve të verifikuara për arsimin e të rriturve;
- të miratojë plane dhe programe kornizë nacionale arsimore për arsimin e të rriturve;
- të miratojë plan dhe program arsimor për arsimin fillor, për arsimin gjimnazor dhe profesional të të rriturve, sipas propozimit të Qendrës për Arsimin e të Rriturve (në tekstin e mëtejshëm: Qendra);
- të sigurojë mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për financimin e arsimimit të të rriturve në bazë të nevojave të përcaktuara të shtetit; dhe
- të sigurojë mjete për kërkime dhe zhvillim për nevojat e arsimit për të rritur, në përputhje me nevojat e shtetit dhe të Unionit Evropian; dhe
- të kryejë punë të tjera konform ligjit.

## **Kompetencat e Ministrisë kompetente për çështjet e punës në fushën e arsimit për të rritur**

### **Neni 8**

Ministria kompetente për çështjet e punës ka kompetencë:

- të marrë pjesë në zbatimin e politikës shtetërore në fushën e arsimit për të rritur, në përputhje me këtë ligj;
- t'i shqyrtojë nevojat për rikualifikim dhe kualifikim plotësues të kuadrit përmes analizës së tregut të punës dhe të paraqesë mendim deri te Këshilli;
- të marrë pjesë në përgatitjen dhe harmonizimin e kualifikimeve profesionale sipas standardeve;
- në bashkëpunimin me Qendrën të iniciojë nevojë për hartimin e kualifikimeve të reja profesionale sipas standardeve;
- të marrë pjesë në hartimin e Listës së standardeve të profesioneve; dhe
- të marrë pjesë në organizimin e orientimit profesional të nxënësve.

## **Këshilli për arsimin e të rriturve**

### **Neni 9**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me vendim themelon Këshill për arsimin e të rriturve (në tekstin e mëtejshëm: Këshill) si trup këshillëdhënës i cili propozon çështje strategjike që kanë të bëjnë me politikën zhvillimore të arsimit për të rritur.

Këshillin e përbëjnë 13 anëtarë prej të cilëve një kryetar dhe 12 anëtarë: dy anëtarë nga radhët e profesionistëve të arsimit për të rritur, nga një anëtar nga Ministria, nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit, nga Qendra e Arsimit dhe Trajnimit Profesional, nga ministria kompetente e financave, nga sindikata shumicë, nga bashkësitë e njëjësive të vetadministrimit lokal, nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë dhe nga Agjencia e Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, si dhe nga një anëtar nga Dhoma Ekonomike e Maqedonisë, nga Lidhja e Dhomave të Maqedonisë, nga Dhoma e Zejtareve të Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: dhomat).

Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të bashkësive në Republikën e Maqedonisë, duke i pasur parasysh gjuhët në të cilat realizohet mësimi nëpër entet arsimore, pa u shkelur kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

Në punën e Këshillit merr pjesë edhe drejtori i Qendrës, pa të drejtë vote gjatë vendimmarrjes.

Këshilli e zgjedh kryetarin nga radhët e anëtarëve të tij. Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjat katër vjet.

Këshilli, punën e vet e rregullon me rregullore. Për punën e vet Këshilli harton plan vjetor dhe raport vjetor dhe e dërgon pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe pranë ministrisë deri në fund të shkurtit të vitit vijues.

Punët profesionale-administrative të Këshillit i kryen Qendra e Arsimit për të Rritur.

## **Kompetencat e Këshillit**

### **Neni 10**

Kompetencat e Këshillit janë:

- që pranë Ministrisë të propozojë strategji për zhvillimin e arsimit për të rritur në kontekst të mësimin të përjetshëm;
- propozon plane aksionale vjetore për implementimin e Strategjisë për arsimin e të rriturve;
- që ta ndjekë realizimin e planeve aksionare vjetore për realizimin e strategjisë së zhvillimit të arsimit për të rritur;
- që Ministrisë t'i propozojë kualifikime dhe standarde nacionale për profesione;
- të propozojë financim të programeve për arsimin e të rriturve për të cilat janë siguruar mjete në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë; dhe
- që në bashkëpunim me komunat pranë Ministrisë të paraqesë propozim për zhvillimin e rrjetit të enteve për zhvillimin e arsimit për të rritur.

## **Kompetencat e njësive të vetadministrimit lokal në fushën e arsimit për të rritur**

### **Neni 11**

Këshilli i komunës përkatësisht i Qytetit të Shkupit:

- bën analizën e nevojave të tregut të punës në nivel lokal dhe për nevojat e njofton Qendrën, entet për arsimin e të rriturve dhe institucionet për arsimin e të rriturve;
- mund të themelojë ente për arsimin e të rriturve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- mund të themelojë qendra komunale përkatësisht qendër të Qytetit të Shkupit për zhvillimin e resurseve njerëzore;
- paraqet propozime pranë Ministrisë dhe pranë Qendrës për nevojat e zhvillimit të programeve për arsimin e të rriturve;
- miraton programe për arsimin e të rriturve të cilat financohen me mjetet e vetadministrimit lokal dhe i dorëzon në verifikim te Qendra;
- siguron mjete për entet e arsimit për të rritur të cilat i ka themeluar; dhe
- pranë Ministrisë paraqet propozime për politikën regjistruese të arsimit për të rritur.
- mban regjistër komunal për entet dhe institucionet që realizojnë programe të njohura publike.

## **Partnerët socialë në fushën e arsimit për të rritur**

#### **Neni 12**

Dhomat i kryejnë punët si vijojnë:

- pranë Qendrës paraqesin propozime për miratimin e programeve të reja dhe për rinovimin e programeve ekzistuese;
- pranë Qendrës paraqesin propozime për hartimin e standardeve të reja të profesioneve;
- mund të themelojë institucione për arsimin e të rriturve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- miratojnë programe të cilat financohen me mjetet e dhomave dhe i dorëzon në verifikim te Qendra.

#### **Neni 13**

Sindikata shumicë i kryen punët si vijojnë:

- pranë punëdhënësve paraqet propozime për përmirësimin e kushteve të aftësisit praktik të pjesëmarrësve;
- mund të themelojë institucione për arsimin e të rriturve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; dhe
- miratojnë programe të cilat financohen me mjetet e sindikatës dhe i dorëzon në verifikim te Qendra.

### **III. ORGANIZIMI I OFERTUESVE TË SHËRBIMEVE TË ARSIMIT PËR TË RRITUR**

#### **Të drejtat dhe obligimet e ofertuesve të shërbimeve të arsimit për të rritur**

#### **Neni 14**

Ofertuesit e shërbimeve të arsimit për të rritur kanë të drejtë:

- të organizojnë dhe realizojnë arsim për të rritur sipas dispozitave të këtij ligji; dhe
- të propozojnë ndryshime dhe plotësime të programeve ekzistuese ose të propozojnë programe të reja.

Ofertuesit e shërbimeve të arsimit për të rritur e kanë për detyrë:

- në mënyrë cilësore ta realizojnë programin për arsimin e të rriturve;
- të sigurojnë kushte të sigurta pune në kuadër të procesit të arsimit për të rritur;
- t'i plotësojnë obligimet e marrëveshjeve me pjesëmarrësit; dhe
- pranë Qendrës të paraqesin raporte vjetore për planet dhe programet arsimore të cilat i realizojnë, për numrin e pjesëmarrësve, kuadrin e angazhuar në procesin arsimor etj.

#### **Lidhja e marrëveshjeve**

#### **Neni 15**

Për kohën e ndjekjes së programit për arsimin e të rriturve lidhet marrëveshje ndërmjet entit dhe institucionit për arsimin e të rriturve dhe pjesëmarrësit.

Në marrëveshjen nga paragrafi 1 të këtij neni, rregullohen kushtet e ndjekjes të arsimit për të rritur (vendi i arsimimit, kohëzgjatja e arsimimit, kompensimi dhe ngjashëm).

Marrëveshja duhet të nënshkruhet para fillimit të realizimit të programit për arsimin e të rriturve.

#### **Neni 16**

Përmbajtjen, formën dhe procedurën e nënshkrimit të marrëveshjes e përcakton Qendra.

### **Programe për arsimin e të rriturve**

#### **Neni 17**

Të rriturit fitojnë arsimim sipas programeve të arsimit fillor, të mesëm dhe sipëror të përshtatura sipas nevojave dhe mundësive të të rriturve (programe publikisht të njohura).

Të rriturit mund të arsimohen dhe përsosen, të specializohen dhe t'i plotësojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre, në përputhje me programet nga paragrafi 1 të këtij neni, në arsimin formal, të cilat mund të organizohen pranë enteve arsimore që janë të verifikuara për këto programe.

Të rriturit mund të arsimohen dhe përsosen, të specializohen dhe t'i plotësojnë njohuritë e tyre, shkathtësitë dhe kompetencat në përputhje me programet e veçanta për fitimin e njohurive dhe shkathtësive të cilat organizohen pranë enteve dhe institucioneve të licencuara arsimore.

#### **Neni 18**

Programet e veçanta për arsimin e të rriturve nga neni 17 paragrafi 3 të këtij ligji, janë për:

- shkrim leximin e popullatës,
- gjuhën amtare dhe për gjuhë të huaja,
- rikualifikim,
- kualifikim plotësues,
- sipërmarrësi dhe menaxhment,
- teknologji informative-komunikative,
- të shprehurit kreativ dhe për pjesëmarrje në evenimente kulturore dhe artistike,
- ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit,
- shkathtësi të veçanta sociale,
- qytetari aktive,
- njohuri themelore nga shkenca dhe teknologjia, dhe njohuri, shkathtësi dhe aftësi të tjera.

Programet nga paragrafi 1 të këtij neni, i janë përshtatur moshës, arsimit të fituar paraprak, njohurive, shkathtësive dhe aftësive të të rriturve.

Programet nga paragrafi 1 të këtij neni, i miraton enti përkatësisht institucioni për arsimin e të rriturve, ndërsa i verifikon Qendra, përveç nëse ndryshe nuk është rregulluar me këtë dhe me ligj tjetër.

#### **Neni 19**

Programi për arsimin e të rriturve e/i përmban:

- emërtimin e programit,
- njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë që fitohen me mbarimin e programit,
- kushtet e regjistrimit, përparimin dhe mbarimin e programit,
- kohëzgjatjen e programit dhe format e realizimit,
- kushtet e kuadrit, kushtet didaktike, hapësinore dhe kushte të tjera për realizimin e programit, dhe
- mënyrën e evoluimit të programit dhe rezultatet e arritura nga mësimi.

#### **Neni 20**

Programet për arsimin për të rritur mund të realizohen përmes: arsimit të rregullt, arsimit konsultativ-instruktiv, arsimit konsultativ me korrespondencë, arsimit të hapur, tele-arsimit, arsimit në distancë, në mënyrë multimediale dhe në mënyrë tjetër përkatëse.

Programi mund të ketë edhe strukturë modulare.

#### **Neni 21**

Programet i realizojnë: arsimtarë, profesorë, instruktorë të arsimit praktik, bashkëpunëtorë profesionistë.

Kuadri nga paragrafi 1 të këtij neni, duhet të ketë përgatitje të veçantë për punë me të rritur, e cila organizohet në Qendër, si dhe në ente dhe institucione përkatëse.

Kuadri nga paragrafi 1 të këtij neni, ka të drejtë dhe obligim në përsosje permanente profesionale, si dhe në përsosje për punë me të rritur.

Në program ceket lloji i kuadrit i cili mund ta realizojë programin.

### **Verifikimi i programeve të veçanta për arsimin e të rriturve**

#### **Neni 21-a**

Enti ose institucioni për arsimin e të rriturve që do të kryejë arsimin e të rriturve për profesione, nevojitet që të Qendra të dorëzojë kërkesë për verifikimin e programit të veçantë me dokumentacionin e nevojshëm në shtojcë.

Për verifikimin e programeve të posaçme, enti ose institucioni për arsimin e të rriturve të Qendra duhet të dorëzojë:

- kërkesë për verifikimin e programit të posaçëm,
- dokument për veprimtarinë e regjistruar - arsim i të rriturve,
- program të veçantë në tri kopje, i hartuar në pajtim me nenin 19 të këtij ligji dhe
- vërtetim për mjete të paguara.



Formularin e kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin e programit të veçantë i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e arsimit në pajtim me ministrin për shoqëri informatike dhe administratë.

Personi i autorizuar zyrtar nga Qendra e cila e mban procedurën për verifikimin e programit të veçantë është i obliguar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për verifikimin e programit të veçantë, me detyrë zyrtare ta kërkojë dokumentacionin nga paragrafi 2 alineja 2 të këtij neni për të cilin organi kompetent publik mban evidencë zyrtare.

Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik prej të cilit është kërkuar dokumentacioni nga paragrafi 2 alineja 2 të këtij neni është i detyruar ta dorëzojë dokumentacionin e kërkuar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Qendra është e detyruar të vendosë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni.

Shpenzimet për verifikimin e programeve bien në ngarkesë të parashtruesit të kërkesës.

Lartësinë e mjeteve për shpenzimet për verifikimin e programeve, e përcakton Këshilli Drejtues i Qendrës në bazë të vëllimit dhe ndërlikueshmërisë së programit që verifikohet.

#### **Neni 21-b**

Verifikimin e programeve të veçanta për arsimin e të rriturve e kryen Qendra pas mendimit paraprakisht të dorëzuar të Komisionit për verifikimin e programit të veçantë për arsimin e të rriturve (në tekstin e mëtuajtshëm: Komisioni për Verifikim), që e formon drejtori i Qendrës.

Komisioni për verifikim përbëhet prej tre anëtarëve: një anëtar nga Qendra dhe dy anëtarë persona profesionistë nga sfera e programit të paraqitur për verifikim.

Kryetari i komisionit është anëtar nga Qendra.

Qendra shpall konkurs publik për zgjedhjen e personave profesionistë për anëtarë të komisioneve për verifikimin e programeve të veçanta për arsimin e të rriturve dhe e shpall në ueb faqen e vet dhe nga kandidatët e paraqitur që i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, i zgjedh anëtarët në Komisionin për Verifikim.

Komisioni për Verifikim punën e vet e rregullon me rregullore për punë.

Anëtarëve të Komisionit për verifikim u takon kompensim për punë, lartësinë e të cilit e përcakton Këshilli Drejtues i Qendrës në bazë të numrit të mendimeve të dhëna për programet që verifikohen.

Mënyrën e verifikimit të programeve të veçanta për arsimin e të rriturve më hollësisht e përcakton Këshilli Drejtues i Qendrës.

Kundër aktvendimit të miratuar për verifikimin e programeve të veçanta, enti ose institucioni ka të drejtë për ankesë në afat prej 15 ditësh te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë.

## **Verifikimi i enteve dhe institucioneve për arsimin e të rriturve**

### **Neni 22**

Verifikimin e enteve dhe institucioneve për arsimin e të rriturve e kryen Ministria.

Enti dhe institucioni për arsimin e të rriturve mund të realizojë programe të posaçme dhe të verifikuara për arsimin e të rriturve, nëse ka lokal, pajisje dhe kuadër përkatës për realizimin e atyre programeve, për çfarë parashtron kërkesë për verifikimin e entit ose institucionit, nëpërmjet Qendrës në Ministri.

Standardet për pajisje, lokal dhe kuadër nga paragrafi 2 i këtij neni, i përcakton ministri, me propozim të Qendrës.

Kërkesa nga paragrafi 2 i këtij neni dorëzohet nëpërmjet Qendrës te Ministria me dokumentacionin në vijim:

- statuti i entit ose institucionit,
- dëshmi për veprimtari të regjistruar - arsim i të moshuarve, të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë,
- elaborati i entit ose institucionit,
- të dhëna për hapësirën, pajisjen, kuadrin mësimor, dëshmi për pronësi/qiramarrje dhe strukturë e hapësirës,
- aktvendim për program të verifikuar nga Qendra dhe
- programin e verifikuar për arsimin e të rriturve.

Formularin e kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin e enteve dhe institucioneve për arsim të të moshuarve i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e arsimit në pajtim me ministrin për shoqëri informatike dhe administratë.

Personi i autorizuar zyrtar nga Qendra i cili e mban procedurën për verifikimin e enteve dhe institucioneve për arsim të të moshuarve është i obliguar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për verifikimin e enteve dhe institucioneve për arsimin e të rriturve, me detyrë zyrtare ta kërkojë dokumentacionin nga paragrafi 4 alinetë 2 dhe 5 të këtij neni për të cilin organi kompetent publik mban evidencë zyrtare.

Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik prej të cilit është kërkuar dokumentacioni nga paragrafi 4 alinetë 2 dhe 5 të këtij neni është i detyruar ta dorëzojë dokumentacionin e kërkuar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Mënyrën e verifikimit të enteve dhe institucioneve për arsimin e të rriturve e përcakton ministri.

Ministria në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për verifikimin e entit dhe institucionit miraton aktvendim me të cilin vendos për kërkesën për verifikimin e entit dhe institucionit (në tekstin e mëtutjeshëm: aktvendim për verifikim).

Kundër aktvendimit të miratuar për verifikim, enti ose institucioni ka të drejtë për ankesë në afat prej 15 ditësh te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë.

#### **Neni 22-a**

Ministria mban Regjistër Qendror për verifikimin e institucioneve të cilat realizojnë programe publikisht të pranuara dhe të veçanta për arsimin e të rriturve, në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

Komuna, përkatësisht Qytetit i Shkupit mban regjistër komunal për entet që realizojnë programe të pranuara publikisht dhe të posaçme, përkatësisht për institucionet që realizojnë programe të posaçme për arsimin e të rriturve nga rajoni i vet në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së Regjistrit Qendror nga paragrafi 1 i këtij neni dhe të regjistrit komunal nga paragrafi 2 i këtij neni, i përcakton ministri.

#### **Provime në fund të arsimit për të rritur**

##### **Neni 23**

Të rriturit njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë e tyre, pavarësisht nga mënyra se si i kanë fituar, mund t'i dëshmojnë përmes dhënies së provimit.

Provimet nga paragrafi 1 të këtij neni, i organizon dhe zbaton enti përkatësisht institucioni për arsimin e të rriturve i cili e ka realizuar programin për fitimin e njohurive, shkathtësive dhe aftësive, përveç maturës shtetërore, maturës shkollore dhe provimit të fundit në shkollën e mesme.

Dhënia e provimit të mjeshtrit dhe provimit për aftësimin profesional realizohet në përputhje me ligjet që e rregullojnë këtë veprimtari.

Mënyra e dhënies së provimeve në arsimin sipëror përcaktohet me ligj.

#### **Certifikata**

##### **Neni 24**

Për njohuritë, shkathtësitë, aftësitë dhe kompetencat e fituara nga programet e veçanta të arsimit për të rritur merret certifikatë.

Emërtimin, përmbajtjen dhe formën e certifikatës nga paragrafi 1 të këtij neni me propozimin e Qendrës, e përcakton ministri kompetent i arsimit, nëse me ligj tjetër ndryshe nuk është përcaktuar.

## **Dokumentacioni dhe evidenca**

### **Neni 25**

Entet përkatësisht institucionet për arsimin e të rriturve mbajnë dokumentacion dhe evidencë.

Dokumentacioni nga paragrafi 1 i këtij neni mbahet në gjuhën maqedonishte dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe alfabetin në të cilën realizohet programi për arsimin e të rriturve. Evidenca nga paragrafi 1 i këtij neni mbahet në gjuhën në të cilën realizohet programi për arsim për të rritur.

Përmbajtjen dhe formën e dokumentacionit dhe evidencës nga paragrafi 1 të këtij neni, sipas propozimit të Qendrës e përcakton Ministri.

### **Neni 26**

Entet përkatësisht institucionet për arsimin e të rriturve e kanë për detyrë që të dhënat për programet që realizohen, për pjesëmarrësit dhe për të dhëna të tjera që kanë rëndësi për ndjekjen dhe zhvillimin e arsimit për të rritur, t'i dërgojnë pranë Qendrës, pranë Entit Shtetëror të Statistikës si dhe pranë komunës përkatësisht Qytetit të Shkupit.

Qendra përgatit raport vjetor për të dhënat dhe e dërgon pranë Ministrisë dhe pranë Këshillit.

## **Të drejtat dhe obligimet e pjesëmarrësve në arsimin për të rritur**

### **Neni 27**

Pjesëmarrës në programet e arsimit për të rritur mund të jetë personi i cili i ka mbushur 15 vjet dhe i cili i përmbush kushtet e tjera të përcaktuara me programin.

Statusi i pjesëmarrësit fitohet me lidhjen e marrëveshjes për t'u inkuadruar në programin e arsimit për të rritur.

Statusi i pjesëmarrësit pushon me mbarimin e programit, me çregjistrimin nga programi ose në mënyrë tjetër të paraparë në marrëveshjen nga neni 15 të këtij ligji.

### **Neni 28**

Pjesëmarrësit kanë të drejtë:

- në qoftë se janë në marrëdhënie pune, gjatë ndjekjes të programit të arsimit për të rritur, mund të shfrytëzojnë pushim në kohëzgjatje prej katër ditësh pune brenda vitit; dhe
- ta prishin marrëveshjen sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje.

Pjesëmarrësit e kanë për detyrë:

- marrëveshjen nga neni 15 të këtij ligji, t'ia paraqesin punëdhënësit;
- t'i respektojnë rregullat për mbrojtje gjatë punës; dhe
- t'i përmbushin edhe obligimet e tjera të cekura në marrëveshjen.

## **IV. FINANCIMI I ARSIMIT PËR TË RRRITUR**

### **Neni 29**

Mjetet për financimin dhe nxitjen e arsimit për të rritur sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, prej buxheteve të njësive të vetadministrimit lokal (në tekstin e mëtejme: mjete publike), prej pjesëmarrësve në arsimin e të rriturve dhe prej burimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

### **Neni 30**

Nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë sigurohen mjete për:

- shpenzimet e realizimit të programeve të arsimit të detyrueshëm për të rritur;
- shpenzimet për realizimin e programeve të arsimit të mesëm për të rritur të cilët kanë mbaruar vetëm arsim fillor përkatësisht programe të tjera arsimore;
- mirëmbajtje në vijim të enteve për arsimin e të rriturve të cilat i ka themeluar shteti; dhe
- shpenzimet e ndjekjes, përparimit dhe zhvillimit të arsimit për të rritur.

### **Neni 31**

Nga buxhetet e njësive të vetadministrimit lokal sigurohen mjete për:

- shpenzime që kanë të bëjnë me realizimin e programeve në entet për arsimin e të rriturve të cilat i ka themeluar njësia e vetadministrimit lokal;
- mirëmbajtje në vijim të enteve për arsimin e të rriturve të cilat i ka themeluar njësia e vetadministrimit lokal; dhe
- investime në entet për arsimin e të rriturve të cilat i ka themeluar njësia e vetadministrimit lokal.

### **Neni 32**

Nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe nga buxhetet e njësive të vetadministrimit lokal mund të akordohen mjete financiare për:

- t'u pajisur me mjete arsimore dhe me mjete tjera; dhe
- zhvillimin dhe realizimin e programeve rinovuese për arsimin e të rriturve.

### **Neni 33**

Mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, të përcaktuara në paragrafin 1, alinetë 1 dhe 2 të nenit 30 të këtij ligji, u akordohen enteve përkatësisht institucioneve për arsimimin e të rriturve në bazë të konkursit publik të cilin e shpall Qendra.

Mjetet nga buxhetet e njësisve të vetadministrimit lokal, të përcaktuara në paragrafin 1, alinenë 1, nga neni 31 të këtij ligji, u akordohen enteve përkatësisht institucioneve për arsimin e të rriturve në bazë të konkursit publik të cilin e shpall njësia e vetadministrimit lokal.

## **V. QENDRA PËR ARSIMIMIN E TË RRITURVE**

### **Themelimi**

#### **Neni 34**

Qendra për arsimimin e të rriturve është ent publik për arsimin e të rriturve në Republikën e Maqedonisë, si person i veçantë juridik.

Qendrën e themelon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

#### **Neni 35**

Në Qendrën harmonizohen dhe integrohen interesat publikë dhe interesat e partnerëve socialë në arsimin për të rritur në Republikën e Maqedonisë.

Qendra e bashkërendit bashkëpunimin me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare në fushën e arsimit për të rritur dhe në mësimin e përjetshëm.

#### **Neni 36**

Qendra i kryen punët si vijojnë:

- e zhvillon arsimin e të rriturve me qëllim të harmonizimit të nevojave të zhvillimit bashkëkohor teknologjik dhe shoqëror;
- i jep përkrahje partneritetit social në të gjitha nivelet dhe fazat e planifikimit, zhvillimit dhe realizimit të arsimit për të rritur;
- e ndërlihdh arsimin e të rriturve dhe punën në kontekstin e mësimin të përjetshëm;
- zhvillon orientim evropian të arsimit për të rritur;
- përgatit koncept për arsimin e të rriturve;
- harton standarde të profesioneve për programet e arsimit për të rritur;
- harton modele për programe publikisht të pranuar dhe të posaçme për arsimin e të rriturve,
- kryen verifikim të programeve të posaçme për arsimin e të rriturve,
- boton katalog për programet publikisht të pranuar dhe të verifikuara të posaçme për arsimin e të rriturve dhe e publikon në faqen zyrtare të internetit të Qendrës,
- siguron përkrahje të arsimit për të rritur përmes këshillimeve, instruktive dhe mentorimit të kuadrit i cili i realizon programet e arsimit për të rritur;
- jep mendim për përmbushjen e kushteve të enteve dhe institucioneve të cilat kërkojnë verifikim për realizimin e programeve publikisht të njohura për arsimin e të rriturve;
- harton standarde për hapësirën dhe pajisjen e enteve dhe institucioneve për arsimin e të rriturve;
- boton katalog të enteve dhe institucioneve të verifikuara për arsimin e të rriturve dhe e publikon në faqen zyrtare të internetit të Qendrës dhe Ministrisë,
- ndërmjetëson në zhvillimin e karrierës dhe në orientimin profesional të pjesëmarrësve në

arsimin për të rritur;

- propozon zgjidhje për përmirësimin e lidhjeve ndërmjet arsimit formal dhe joformal;
- pranë Ministrisë dhe Këshillit paraqet raport vjetor për realizimin e planeve aksionare vjetore të strategjisë për zhvillimin e arsimit për të rritur; dhe
- pranë Ministrisë paraqet raport vjetor për konkurset e shpallura publikisht për akordimin e mjeteve për realizimin e programeve për arsimin e të rriturve.

#### **Neni 37**

Qendra bashkëpunon me:

- Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës;
- Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale;
- Ministrinë e Ekonomisë;
- Ministrinë e Vetadministrimit Lokal;
- Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë;
- Agjencinë për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme;
- Entin Shtetëror të Statistikës;
- Dhomën Ekonomike të Maqedonisë;
- Lidhjen e Dhomave Ekonomike të Maqedonisë;
- Dhomën e Zejtarëve të Maqedonisë;
- Sindikatën;
- Sindikatat në Republikën e Maqedonisë;
- Bashkësitë e Njësive të Vetadministrimit Lokal;
- Shoqatën e universiteteve të punëtorëve dhe popullorë të Maqedonisë;
- Byronë e Zhvillimit të Arsimit;
- Qendrën Shtetërore të Provimeve;
- Qendrën për Arsim Profesional dhe Aftësim;
- entet dhe institucionet për arsimin e të rriturve;
- universitetet në Republikën e Maqedonisë;
- qendrat lokale për zhvillimin e resurseve njerëzore;
- institucione dhe organizata ndërkombëtare nga fusha e arsimit për të rritur, dhe
- sektorin joqeveritar.

#### **Menaxhimi dhe drejtimi me Qendrën**

##### **Neni 38**

Me Qendrën menaxhon Këshilli drejtues.

Këshilli drejtues përbëhet prej 11 anëtarëve edhe atë dy anëtarë nga Ministria, nga një anëtar nga ministria kompetente për punë dhe nga Bashkësia e Njësive të Vetadministrimit Lokal, Dhoma Ekonomike e Maqedonisë dhe Lidhja e Dhomave Ekonomike të Maqedonisë dhe Dhoma e Zejtarëve të Maqedonisë dhe katër anëtarë nga radhët e punonjësve profesionistë të punësuar pranë Qendrës.

Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit drejtues zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të bashkësive në Republikën e Maqedonisë, duke i pasur parasysh gjuhët në të cilat realizohet mësimi në arsimin fillor dhe të mesëm, pa u shkelur kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

Këshilli drejtues nga radhët e anëtarëve të tij e zgjedh kryetarin.

Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit drejtues zgjat katër vjet.

Anëtarët e Këshillit drejtues i emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

### **Neni 39**

Këshilli drejtues i Qendrës:

- e nxjerr Statutin e Qendrës;
- e miraton programin vjetor për punën e Qendrës;
- Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i propozon plan financiar vjetor dhe llogari përfundimtare;
- publikon shpallje publike për emërimin e drejtorit, në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra nga gazetatat që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.
- bën intervistë me kandidatët për drejtor prej kandidatëve të paraqitur;
- bën zgjedhjen e drejtorit prej kandidatëve të paraqitur në shpalljen e publikuar publikisht;
- e shkarkon drejtorin;
- vendos sipas kundërshtimeve dhe ankesave të punonjësve të Qendrës; dhe
- bën edhe punë të tjera të përcaktuara me Statutin.

Statutit të Qendrës pëlqim i jep Ministria.

### **Neni 40**

Me Qendrën udhëheq drejtori.

Për drejtor mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose të kryer shkallën VII/1 të arsimit;
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune në sferën e arsimit dhe
- 5) posedon një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtare vijuese ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
  - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
  - IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
  - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
  - FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,
  - BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë ose
  - APTIS (APTIS) - niveli me i vogël B2 (B2).



Mandati i drejtorit të Qendrës zgjat katër vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

#### **Neni 41**

Drejtori i Qendrës:

- e organizon dhe e drejton punën e Qendrës;
- përgjigjet për punën e ligjshme të Qendrës;
- e përfaqëson Qendrën para personave të tretë;
- e propozon programin vjetor për punën e Qendrës;
- i ekzekuton vendimet e Këshillit drejtues të Qendrës;
- vendos për të drejtat nga marrëdhënia e punës të të punësuarve në Qendër; dhe
- bën edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me Statutin e Qendrës.

#### **Neni 41-a**

Për të punësuarit në Qendrën të cilat kryejnë punë administrative zbatohen dispozitat nga Ligji për nëpunës administrativë dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik, kurse për të punësuarit që kryejnë punë ndihmëse teknike zbatohen dispozitat nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligji për marrëdhënie pune.

### **Financimi i punës të Qendrës**

#### **Neni 42**

Mjetet e nevojshme për realizimin e veprimtarisë së Qendrës sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe prej burimeve vetjake nga shërbimet e kryera, si dhe nga legët, dhuratat, donacione dhe prej burimeve të tjera.

## **VI. MBIKËQYRJE**

#### **Neni 43**

Mbikëqyrje inspektimi dhe mbikëqyrje mbi cilësinë e punës të enteve përkatësisht institucioneve për arsimin e të rriturve bën Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Mbikëqyrje profesionale mbi punën e entit përkatësisht institucionit për arsimin e të rriturve bën Qendra.

#### **Neni 43-a**

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese Inspektorati Shtetëror i Arsimit konstaton se për herë të parë është kryer parregullsi nga neni 44 paragrafi (1) alinetë 1 dhe 2 të këtij ligji, është i detyruar që të përpilojë procesverbal ku do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanim të parregullsisë së përcaktuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëhershëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose entit përkatësisht institucionit ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

- (2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit i përcakton ministri.
- (3) Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shtetëror i Arsimit që e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e realizimit të mbikëqyrjes inspektuese.
- (4) Edukimi mundet të realizohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjta ose të ngjashme për një ose më shumë persona, ose për një ose më shumë ente përkatësisht institucione.
- (5) Nëse në terminin e caktuar personi ose enti përkatësisht institucioni për të cilin realizohet edukimi nuk lajmërohet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.
- (6) Nëse personi ose enti përkatësisht institucioni për të cilin realizohet edukimi lajmërohet në edukimin e caktuar dhe të njëjtin e kryen, do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me parregullsinë e konstatuar.
- (7) Nëse Inspektorati Shtetëror i Arsimit gjatë realizimit të mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) të këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.
- (8) Nëse Inspektorati Shtetëror i Arsimit gjatë realizimit të mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente.
- (9) Inspektorati Shtetëror i Arsimit që e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri.

## **VII. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE**

### **Neni 44**

- (1) Gjobë në shumë prej 1.500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje entit, përkatësisht institucionit për arsimin e të rriturve, nëse:
- mban evidencë dhe dokumentacion në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 25) dhe
  - nuk dorëzon të dhëna të parapara në nenin 26 të këtij ligji.
- (2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për institucionin, përkatësisht institucionin për arsimin e të rriturve do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në institucionin, përkatësisht institucionin për arsimin e të rriturve.
- (3) Gjobë në shumë prej 2.500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje entit, përkatësisht institucionit për arsimin e të rriturve, nëse:
- nuk lidh marrëveshje me pjesëmarrësin në arsimin e të rriturve (neni 15) dhe
  - pjesëmarrësit i arkëton shpenzime, e të njëjtat sigurohen nga mjetet publike.

(4) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për institucionin, përkatësisht institucionin për arsimin e të rriturve do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (3) i këtij neni personit përgjegjës në institucionin, përkatësisht institucionin për arsimin e të rriturve.

(5) Gjobë në shumë prej 3.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje entit, përkatësisht institucionit për arsimin e të rriturve, nëse:

- fillon të realizojë program të veçantë për pjesëmarrësit, para miratimit të aktvendimit për përmbushjen e kushteve lidhur me lokalin, pajisjen dhe kuadrin profesional (neni 22) dhe
- mjetet e ndara publike në konkurs i shpenzon pa dedikim.

(6) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për institucionin, përkatësisht institucionin për arsimin e të rriturve do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (5) i këtij neni personit përgjegjës në institucionin, përkatësisht institucionin për arsimin e të rriturve.

Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga Qendra i cili e mban procedurën, nëse:

- nuk i siguron dëshmitë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 21-a paragrafi 4 dhe neni 22 paragrafi 6 nga ky ligj) dhe
- nuk vendos për kërkesën në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 21-a paragrafi 6 dhe neni 22 paragrafi 9 nga ky ligj).

Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik prej të cilit janë kërkuar dëshmitë dhe të dhënat nëse nuk i dorëzon dëshmitë dhe të dhënat e kërkuara në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 21-a paragrafi 5 dhe neni 22 paragrafi 7 nga ky ligj).

#### **Neni 44-a**

Matja e lartësisë së gjobës për institucionin, përkatësisht institucionin për arsimin e të rriturve bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.

#### **Neni 44-b**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji, inspektorati shtetëror i arsimit është i detyruar që kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhëresë pagesore për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Nëse kryerësi e pranon urdhëresën pagesore për kundërvajtje, të njëjtin duhet ta nënshkruajë. Pranimi i urdhëresës pagesore për kundërvajtje nga kryerësi i kundërvajtjes shënohet në procesverbal.

(3) Në procesverbalin nga paragrafi (2) i këtij neni, konstatohet mënyra në të cilën do të mënjanohej pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e kryer.

(4) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdhëresën pagesore për kundërvajtje e nënshkruan drejtori i shkollës fillore ose personi i autorizuar nga ai.

(5) Inspektorati Shtetëror i Arsimit është i detyruar që të mbajë evidencë për urdhëresat pagesore për kundërvajtje dhe për rezultatin nga procedurat e ngritura.

(6) Në evidencën nga paragrafi (5) i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhëresës pagesore për kundërvajtje që i lëshohet edhe rezultati i procedurës.

(7) Të dhënat personale nga paragrafi (6) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

(8) Ministri i Arsimit dhe Shkencës i përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhëresës pagesore për kundërvajtje.

#### **Neni 44-v**

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj procedurë për kundërvajtje dhe sanksione për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

## **VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 45**

Entet, përkatësisht institucionet në të cilat realizohet arsimi i të rriturve brenda afatit prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do ta harmonizojnë organizimin e tyre, punën, statutet dhe aktet e tjera të përgjithshme me dispozitat e këtij ligji.

#### **Neni 46**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta themelojë Qendrën për arsimin e të rriturve brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta themelojë Këshillin për arsimin e të rriturve brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 47**

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, do të miratohen brenda afatit prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në hyrjen në fuqi të akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, do të zbatohet Rregullorja për kriteret dhe mënyrën e realizimit të arsimit fillor për të rritur (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/96).

#### **Neni 48**

Të punësuarit në Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe të Qendrës për arsim profesional dhe trajnim të cilët punojnë në fushën e arsimit për të rritur vazhdojnë me punë si të punësuar në Qendrën për arsimin e të rriturve prej ditës së themelimit të saj.

Mjetet, pajisja, inventari, dokumentacioni që kanë të bëjnë me punën e të punësuarve nga paragrafi 1 të këtij neni, kalojnë pranë Qendrës nga dita e themelimit të saj.

**Neni 49**

*I shfuqizuar*

**Neni 50**

*I shfuqizuar*

Pronësia mbi objektet dhe pronën e universiteteve të punëtorëve dhe popullorë nga paragrafi 1 të këtij neni, që janë pronë e Republikës së Maqedonisë, me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i kalon komunës përkatësisht Qytetit të Shkupit për universitetet e punëtorëve dhe popullorë në rajonin e tyre.

Të punësuarit, mjetet, pajisja, inventari dhe dokumentacioni që kanë të bëjnë me punën e universiteteve të punëtorëve dhe popullorë nga paragrafi 2 të këtij neni, i kalojnë komunës, përkatësisht Qytetit të Shkupit për universitetet e punëtorëve dhe popullorë në rajonin e tyre.

**Neni 51**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

**DISPOZITA NGA NJË LIGJ TJETËR**

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin e të rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2011):

**Neni 3**

Aktet nënligjore të parapara në nenin 43-a të këtij ligji, ministri do t'i miratojë në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin e të rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):

**Neni 4**

Drejtori i Qendrës i zgjedhur deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdon ta ushtrojë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është i zgjedhur.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin e të rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):

**Neni 6**

Dispozitat nga neni 2 nga ky ligj që kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj që do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozitat nga neni 3 i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14) dhe Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14).

#### **Neni 7**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse do të fillojë të zbatohet pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin e të rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 146/2015):

#### **Neni 3**

Akti nënligjor i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin e të rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 146/2015):

#### **Neni 5**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin e të rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2016):

#### **Neni 7**

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin për të cilin ishin të filluara.

#### **Neni 8**

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin e të rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2016):

#### **Neni 9**

Dispozitat nga nenet 1, 2, 3, 4 dhe 6 nga ky ligj, do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

#### **Neni 11**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin e të rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2018):

#### **Neni 2**

Dispozitat e nenit 40 paragrafit (2) pikës 5) të Ligjit për arsimin e të rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 7/2008, 17/11, 51/11, 74/12, 41/14, 144/14, 146/15 dhe 30/16) dhe dispozitat e nenit 1 të këtij ligji me të cilat neni 40 paragrafi (2) pika 5) plotësohet me alinenë 6, nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin e të rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2018):

**Neni 3**

Drejtori i cili është i emëruar në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018, është i obliguar që ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj më së voni deri në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij.

Drejtori i cili nuk do ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i ndërpritet mandati.